



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.7.2024, merr këtë:

V E N D I M

- I.** Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare “Klubin e Futsallit Prishtina 01 – FCF. Prishtina 01”.
- II.** Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 20,000.00 € (njëzetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
- III.** Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, Klubit të Futsallit Prishtina 01, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për vazhdimin e suksesit, si dhe realizimin e objektivave për synimin e shpalljes kampion i Kupës së Kosovës dhe Titullin Kampion në Futsall.
- IV.** Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e “Klubin e Futsallit Prishtina 01 – FCF. Prishtina 01”.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave në Komunën e Prishtinës.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-022/01-99498/24, më 31.7.2024

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupa

